

V E N D I M
Nr.599, datë 2.11.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E FUSHË-
ARRËZIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Fushë-Arrëzit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Fushë-Arrësit.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 1250 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Fushë-Arrëzit, kërkuar për shpronësim, në shumën 128 000 (njëqind e njëzet e tetë mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Fushë-Arrëzit.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA FUSHË - ARRËZIT**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera lekë
1	Dila Gjini Deda	1250	320	400.000